

FJALA E DEPUTETES MIRELA KUMBARO

E ENJTE 20 TETOR 2022

Unë do ta nis fjalën duke falënderuar një koleg të opozitës, zotin Agalliu, i cili, me shumë të drejtë, kërkoi informacion më të detajuar!

Besoj se është shumë e rëndësishme për të kuptuar më mirë dhe me të drejtë, sepse zoti Agalliu është deputet i ri në parlament dhe ndoshta nuk ka qenë i përfshirë në politikë kur ka filluar marrëveshja me Bankën Botërore. Pa diskutim duhet të ketë qenë një qytetar i angazhuar, përderisa sot është në politikë, dhe unë i vlerësoj jashtëzakonisht shumë të tilla prurje. Ndaj, ndryshe nga çfarë kisha menduar për këtë fjalim, po e nis me disa informacione posaçërisht për ju, dhe përmes jush, edhe për publikun, sigurisht.

Në mandatin e parë, kur unë isha në detyrën e ministres së Kulturës, është mirë ta kujtojmë, sepse kanë kaluar tashmë më shumë se 9 vjet, nuk arrinim të kishim asnjë vëmendje nga institucionet ndërkombëtare, banka kreditore apo donatorë për trashëgiminë kulturore. Për ta ishte pa interes, sepse nuk mendonin se ishte një investim, bashkëinvestim apo një hua që do të kthehej në vlerë. Nuk mund të ishte ndryshe, sepse Ministria e Kulturës në vitin 2013 la një buxhet vetëm 9 milionë euro për gjithçka, që nga rrogat deri te restaurimet, dhe një borxh prej 2,5 milionë euro, të cilin e kemi shlyer më pas. Për supet e brishta të Ministrisë së Kulturës ishte shumë e rëndë, por jo vetëm kaq. Vlen gjithmonë të kujtojmë se inventari i fundit i pasurive kulturore në Republikën e Shqipërisë, ishte bërë në vitin 1984 deri në atë kohë dhe prej asaj kohe kjo Republikë nuk dinte ku i kishte pasuritë dhe në çfarë gjendje ishin.

Çfarë situatë trashëguam?! Në vitin 2015, pas një verifikimi objekt më objekt, sipas listës që trashëguam, e kemi bërë këtë proces në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe konstatuam, ndër të tjera, që mbi 102 objekte në listë ishin shkatërruar, nuk ekzistonin në territor, sepse asnjëherë, as pas vitit të tmerrshëm 1997 nuk u mor frymë dhe të thoshin: “çfarë ndodhi në vitin 1997 me pasuritë kulturore”? Trashëgimia kulturore nuk ekzistonte në projekte, në vizion, në programe, në politika. Nuk po them se 600 prej tyre ishin të shkatërruara, por 102 nuk ekzistonin më në territor.

Në vitin 2014 kuptuam se qendrat historike, krenaria jonë kombëtare, trashëgimia botërore e UNESCO-s në Berat dhe në Gjirokastrë, ishin vetëm dy qytete të trishta, ku jeta mbaronte në orën 15:00 dhe ku përtej 15 gushtit nuk shkelte këmbë as turisti vendor, jo më të huajt. Kjo ishte arsyeja pse në atë kohë filluam të mobilizonim mjetet, punën dhe të përgatisim projekte, duke filluar nga zemrat e qyteteve. Kjo shkoi paralelisht me të gjithë programin e rilindjes urbane, që preku çdo qytet të Shqipërisë dhe sigurisht që do të prekte Gjirokastrën, Beratin, që ishin krenari botërore, jo vetëm kombëtare.

Ishte shumë e vështirë ta bënim me buxhetet e trashëguara, se nuk kishim çfarë të bënim më parë, por ishte edhe më e vështirë të bindnim donatorët pse ia vlente ta bënim këtë investim, që nuk ishte thjesht për të rregulluar dy çati, për të restauruar një kishë apo disa rrugica, por investim për t’u dhënë njerëzve besimin që ia vlen të investohet në trashëgimi kulturore, sepse një pjesë e madhe e trashëgimisë kulturore është pronë private, e cila për kushtet e vështira dhe të kushtueshme për t’u mbajtur, ishte braktisur nga trashëgimtarët ndër vite.

Me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan të Zhvillimit bashkuam fondet e qeverisë shqiptare dhe filluam projektin e restaurimit të Qafës së Pazarit në Gjirokastrë, të zonës historike në Berat, në Krugë, në Tiranë,

transformuam Pazarin e Korçës, u futëm në Vlorë, në Shkodër, dhe tashmë jemi futur në Durrës e kështu me radhë.

Në vitin 2015 kam zhvilluar takime shumë intensive me drejtoreshën e asaj kohe të Bankës Botërore, një zonjë shumë e nderuar, të cilin më vjen mirë ta falënderoj për dy gjëra: e para, sepse në fillim ishte shumë kokëfortë dhe thoshte: “Nuk ia vlen. Banka Botërore nuk është futur asnjëherë në projekte të qendrave kulturore, të qendrave historike; ka bërë infrastrukturë, spitale, gjëra të kësaj natyre. Nuk ia vlen të bëhet”! Por, punët e para të bëra në trashëgiminë kulturore, restaurimet dhe reagimi i komunitetit e bindën Bankën Botërore që për të parën herë në historinë e saj të fuste në Shqipëri pikërisht një projekt të dedikuar për zhvillimin e turizmit përmes trashëgimisë kulturore. Shqipëria ishte ndër të parat vende me të cilat Banka Botërore po e bënte këtë, mund të ishin edhe 2-3 vende të tjera.

Ndërkohë, ishte interesante që komuniteti filloi të reagoonte menjëherë. Në vitin 2016, në 3 vitet e para të mandatit të parë, kur u pa efekti i Pazarit të Korçës, kur u pa efekti në Pazarin e Krujës, kur u pa se si po reagoonte Berati në hapat e parë, Banka Botërore pranoi të përpunonte dhe të firmoste me ne një marrëveshje huaje prej 63 milionë eurosh, ku përfshiu Beratin, Gjirokastrën dhe Sarandën si tri destinacione tradicionale klasike të mirënjohura, që për shkak të emrit të tyre premtinin më shumë interes për komunitetin. Përmeti nuk e kishte fillimisht, para se të firmosnim, sepse nuk e dinin ku binte Përmeti, nuk i bindnim dot që Përmeti ishte një destinacion i jashtëzakonshëm, një Toskanë e vogël Shqipërie. Ekspertët, drejtoresha dhe drejtori nga Washingtoni erdhën vetë për të parë Përmetin, ujërat termale të Benjës, për të takuar njerëzit, përmetarët, me të cilët ne deri dje krenoheshim nëpërmjet vëllezërve Frashëri, pa e pasur idenë se ku ishte Përmeti, ndërkohë që është brenda qarkut të Gjirokastrës. Ne mjaftueshëm me krenari i biem gjoksit, por njerëzit që jetojnë atje mbajnë traditën, kanë vlerën dhe meritojnë të investohen. Përmeti u fut në këtë program.

Çfarë ka prodhuar? Nuk po u futem shifrave që tha ministrja më parë, pasi ishin shumë të qarta, por mund t’ju jap disa shifra që janë të qarta edhe për publikun.

Në vitin 2019, në vitin më të mirë të turizmit, Përmeti numëronte 38 mijë vizitorë, një sukses i jashtëzakonshëm për qytetin, sepse dy hotelet që kishte përdorshin vetëm nga nëpunësit e shtetit kur shkonin me shërbim, herë ai i taksave, herë ai i bujqësisë e kështu me radhë. Ishin 38 mijë vizitorë dhe Përmeti nuk i përballonte. Vizitorët shkonin e vizitonin dhe më pas iknin për të fjetur në Gjirokastër ose ktheheshin pas, sepse nuk kishin shtretër. Në vitin 2020 Përmeti kishte 600 shtretër. Sot kemi mbi 1000 shtretër vetëm në harkun e 2 vjetëve e gjysmë dhe deri në shtator të këtij viti numërohen 60 mijë vizitorë.

Gjirokastra kishte 6900 vizitorë në vitin 2013 dhe pati 150 mijë vizitorë turistë deri më 30 shtator të këtij viti. Ia vlen të bëni një shëtitje në Gjirokastër, sepse sapo janë hapur dy muze të reja, pjesë e investimeve të këtij projekti: Muzeu Etnografik, një muze spektakolar, shkoni për kënaqësinë tuaj, dhe Muzeu i Shtëpisë Kadare, i jashtëzakonshëm, modern. Madje, që të keni një ide, besoj se shumica nga ju e kanë vizituar Muzeun Marubi, është i njëjti arkitekt që na ndihmoi të bënim projektet e këtyre dy muzeve.

Gjithashtu, po konsolidohet dhe restaurohet pjesa më e vështirë e Kalasë së Gjirokastrës. Ju kujtohen reshjet, lëvizjet tektonike të vitit 2018, shkarjet e dheút që pësuan në Gjirokastër dhe nami që u bë. Kalaja është pjesë e të njëjtit projekt.

Po ashtu, qendra historike e Gjirokastrës është pjesë e të njëjtit projekt.

Në lagjet historike në Përmet, të gjitha të rrjetëzuara, po shtohen hotelet dhe vetëm në këto 3 vitet e fundit janë 15 ferma në listën e agroturizmeve, që janë 260 në të gjithë Shqipërinë.

Gjithashtu, është investuar Berati në hyrjet e veta kryesore.

Nuk kam shumë kohë në dispozicion, por dua të them se për ndërhyrjet e bëra, të vish këtu e të thuash “nuk është bërë asgjë”, do të thotë se ose nuk ke qenë asnjëherë në Berat, në Gjirokastrë, në Sarandë dhe në Përmet, dhe për këtë më vjen shumë keq, por nuk është asnjëherë vonë, mund t’i vizitoni, ju presim me shumë dashuri dhe me shumë zemër, dhe nuk ka fare rëndësi çfarë kahu politik jeni; ose vërtet ju zënë sytë aq shumë pjesa e flamurit të partisë, saqë të gjithë njerëzve që banojnë atje, që përfitojnë, që kanë shtuar hotelet, bizneset, siç ka ndodhur në Gjirokastrë, siç ka ndodhur në Berat, siç ka ndodhur në Sarandë siç ka ndodhur në Përmet, t’u thuash: “ju nuk ekzistoni për ne” dhe ky është një gjynah shumë i madh, në raport me njerëzit që punojnë përditë.

Përmetarët, beratasit, sarandjotët, gjirokastritët janë njerëzit më punëtorë. Tani, ky model që është aplikuar atje do të replikohet në Orikum, në Borsh dhe në Ksamil, sigurisht, edhe për të rregulluar problemet që trashëguam nga tranzicioni, kaosin e tij, por edhe për të arritur atë që kemi thënë të gjithë: “Shqipëria do të jetë kampione turizmi në Ballkan, për vitin 2030” dhe për këtë kemi kontribut të gjithë. Faleminderit edhe një herë, zoti Agalliu!